

PASHKË 2005

## Krishti u Ngjall! Vërtet u Ngjall!

Klerit të përndershëm, murgjërës dhe besimtarëve të Kishës Ortodokse në Amerikë

Shumë të dashur te Zoti:

Përshëndesim edhe një herë njëri-tjetrin me këto fjalë gazmore, të cilat jo vetëm përmbledhin thelbin e krenimit pashkal, por mishërojnë esencën e vetë besimit tonë dhe shpresën të dashurisë së Zotit.

Në qendër të besimit tonë janë fjalët e shën Pavlit, “nëse Krishti nuk është ngjallur, predikimi ynë është i kotë dhe njësoj i kotë është dhe besimi juaj” (1 Korinthianëve 15:14). Duke dëshiruar të pajtojë gjithë krijesën me Krijuesin, Biri i vetëmlindur i Perëndisë mori trup njeriu dhe hy në historinë e njerëzimit, në kohë e në hapësirë, ashtu si njëri prej nesh. Nuk erdhi që t’i shërbejnë, por erdhi për të shërbyer. Dhe kështu Ai na zbuloi se Perëndia “nuk është Perëndi i të vdekurve, por i të gjallëve” (Matheu 22:32), është Perëndia që dëshiroi ripërtëritjen dhe transformimin e popullit të tij dhe të gjithë krijesës, me një forcë të tillë sa që ishte gati të vdiste, në mënyrë që jeta të mbretërojë. Me vdekjen dhe ngjalljen e Tij, Ai na udhëhoqi në një tokë të re premtimi, atje ku nuk ka sëmundje, trishtim, as gulçima, por jetë të amëshuar. Është pikërisht ky realitet që shpallim në këtë shprehje besimi të thjeshtë në dukje, por të thellë në kuptim, “Krishti u ngjall! Vërtet u ngjall!”

Megjithatë, si të krishterë ortodoksë, nuk do të mjaftohemi t’i ndajmë këto fjalë vetëm me “tanët”. Para ngjitjes në qiej, Zoti i ngjallur porositi që lajmi i mirë i Ngjalljes t’iu lëçitet gjithë kombeve, atyre që vazhdonin në errësirë, atyre që ende nuk kishin shpresë. E kush mund të vërë në dyshim se bota ku jetojmë dhe shoqëria ku shërbejmë nuk kanë nevojë skajore për atë jetë që shndrit nga varri i zbrazët i Krishtit? Ka shumë që e shohin kulturën bashkëkohore si “kulturë të vdekjes”, si kulturë që e vlerëson jetën, por vetëm nëse kjo ka njëfarë “domethënieje prodhimtare” a “energji rinore”. Ngjarjet e fundit vërtetojnë se në shumë raste jeta shihet si diçka që mund të zgjatet, ose që edhe mund të shkurtohet, dhe kjo ndodh atëherë kur, sidomos në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, jeta shfaqet pa domethënie, pa vlera. Në vend që të biem në dëshpërimin që



P.O. Box 675  
Syosset, NY 11791-0675  
Tel: 516.922.0550  
Fax: 516.922.0954  
Website: [www.oca.org](http://www.oca.org)

Chancellor:  
Protopresbyter  
Robert S.  
Kondratik

përpiqet të ngushëllohet te “vdekja me dinjitet”, apo në sentimentalizma të ngjashëm zbrazëtie, a nuk është sfidë t’ a ndajmë guximshëm dinjitetin që i jepet gjithë krijesës nga ngjallja? Ky është dinjitet i vërtetë për vetë saktësinë e faktit se Perëndia e deshi kaq shumë botën saqë e ripërtërin si “Perëndi i të gjallëve”, në emër të jetës së përjetshme. Për më tepër ky dinjitet është ai që Zoti i jep “çdo njeriu që vjen në botë”, themeluar e përsosur në “jetën e amëshuar”, tek e cila dinjiteti i vërtetë nuk gjendet në sëmundje, as në trishtime, as në rënkime, por në jetën e pasosur.

Nëpërmjet vdekjes Krishti duroi poshtërimin e skajshëm, ndërsa përmes Ngjalljes Ai na jep dinjitet, ne dhe gjithë krijesës, duke ndarë me ne ngadhënjimin final dhe lavdinë hyjnore, duke na sjellë, pra, nga pragu i dëshpërimit drejt gëzimit të jetës së amëshuar. Uroj që gjatë kësaj kohe më se të shenjtë të vitit e më tej, të shpallim Ngjalljen e Krishtit, domethënë thelbin e besimit tonë, jo vetëm midis nesh, por të rrokim çdo rast dhe të lëçisim Zotin e Ngjallur dhe jetën e amëshuar që Ai iu dhuron gjithë atyre që do t’ a përqafojnë, ashtu siç bënë apostujt.

Me dashuri te Zoti i Ngjallur,

**+Hermani**

Kryepeshkop i Uashingtonit

Mitropolit i Gjithë Amerikës dhe Kanadasë